

Dr. Shyqyri HYSI

## KONGRESI I TIRANËS DHE VENDIMET E RËNDËSISHME TË TIJ

Vitet 1918-1920 për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare kishin një rëndësi vendimtare. Nga konceptimi dhe veprimet e kësaj lëvizjeje dhe nga qëndrimi i Fuqive të Mëdha varej fati i shtetit të cinguar shqiptar, i cili ishte vetvendosur me aktin e 28 Nëntorit 1912 dhe ishte ligjëruar prej Konferencës së Ambasadorëve 1912-1913. Rreziku i copëtimit ishte i prezent. Ky rrezik vihet re: në premisat për zbatimin e Traktatit të Fshehtë të Londrës të 26 prillit 1915; në marrëveshjen Titoni-Venizello në korrik të 1919-ës; në qëndrimin e Qeverisë së Durrësit dhe në rolin antikombëtar të disa feudalëve shqiptarë, ku spikat veprimtaria antikombëtare e Esat Pashë Toptanit; në pranimin, edhe pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, të ushtrive të huaja në territorin shqiptar, si ato italiane, greke serbe, të cilat, në këtë periudhë, pushtuan disa teritore të shtetit politik shqiptar, madje edhe Tiranën; në krijimin e komitetetve në zonën Vlora në Durrës inicuar prej italianëve, të cilët kishin mision të dyfishtë dhe të dyshimtë; në faktin që Shqipëria nuk u ftua si palë e dëmtuar në Konferencën e Parë të Paqes, Paris 1919 etj.

Shpërbërja e Austro-Hungarisë ndikoi në prishjen e balancës ndërkombëtare dhe rrezikimin e Çështjes Shqiptare. Italia kishte ndryshuar qëndrimin e vitit 1913, duke kërkuar tashmë copëtimin dhe nënshtrimin e Shqipërisë. Një rol tejet negativ luajti klasa politike shqiptare, e cila ishte e përçarë dhe pa udhëheqje të nivelit si ajo në kohën e Shpalljes së Pavarësisë.

Në këto kushte, nga dhjetori i vitit 1918 deri në janar të vitit 1920 u zhvilluan disa kongrese e takime (mbledhje), të cilat kishin për qëllim zotërimin e situatës pas Luftës së Parë Botërore. Si të tilla, mund të përmendim Kongresin e Tiranës (19 dhjetor

1918), Kongresin e Durrësit (25 dhjetor 1918), mbledhjen e Dibrës (dhjetor 1918), mbledhjen e Krujës (11 janar 1919) dhe Kongresin e Tiranës (maj 1919). Gjithashtu, u bënë përpjekje për organizimin e një kongresi mbarëkombëtar, përpjekje që u kurorëzuan me zhvillimin e Kongresit të Lushnjës, më 28-31 janar 1920. Zhvillimit të tij i parapriu Kongresi i Tiranës (dhjetor 1918), ku një rol të rëndësishëm organizues luajti edhe ish-nënprefekti Rauf Fico.<sup>1</sup>

“Lëvizja Kombëtare në vitet 1918-1920, – thekson studiuesi Muin Çami, – e vuri theksin në krijimin e Senatit”<sup>2</sup>. Por, pasi në dritë kanë dalë dokumente të reja, duhet theksuar se kjo ide u përkrah dhe u kontrollua prej Qeverisë së Durrësit, ide që nuk mundi të realizohej as me thirrjen e Kongresit të Durrësit. Lumo Skëndoja, në një letër dërguar nga Durrësi më 27 gusht 1919, thekson: “*Opiniononi publik asht i mendimit që kongresi të vendos formimin e senatit, e senati, ta rrëzoi qeverinë që ekziston (Qeverinë e Durrësit–Sh.H.)*.”<sup>3</sup> Në të njëjtën linjë vepronin edhe atdhetarët tiranas. Ishte koha kur mungonte qendra politike kombëtare dhe, në mungesë të saj, çdo krahinë u përpoq të formonte organet e pushtetit lokal për të mbushur boshllëkun e krijuar. Më 7 dhjetor të vitit 1918, atdhetarët tiranas hartuan thirrjen e parë për mbrojtjen e interesave kombëtare të popullit shqiptar<sup>4</sup>. Në procesverbalin e kësaj mbledhjeje, që u mbajt në zyrën e Rauf Ficos\*<sup>5</sup> shkruhet: “*Vendim i marrun për mbledhjen e kongresit në Tiranë. (origjinal i vetëm). Në mbledhjen që u bë në mes t’onë më 7-12-‘18 në Tiranë u vendos që të grishen (thirren) qarqet: Elbasan, Peqin, Kavaj, Durrës, Krujë, Mat, Dibër, për me ba një bisedë përmbi qetësinë e bashkim të plotë të këtyne viseve më 19-12-918 të enjten të bëhet mbledhja.*”<sup>6</sup>

Thirrja u hartua nga atdhetari Abdi Bej Toptani, i cili ishte organizatori dhe mbështetësi i kësaj veprimtarie. Në një takim të organizuar në zyrën e nënprefektit Rauf Fico më 7 dhjetor 1918, Sotir Peci, Abdyl Ypi, Ismail Ndroqi, Mytesim Këlliçi, Sinan Hoxha, Myslim Beshiri dhe nënprefekti (R.F.),<sup>7</sup> nënshkruan thirrjen apo një dokument, siç e quan Ficoja, me të cilin ftoheshin të merrnin pjesë në këtë mbledhje nga dy përfaqësues të: Tiranës, Elbasanit, Gramshit, Peqinit, Durrësit, Kavajës, Krujës, Matit dhe Dibrës<sup>8</sup>. Për këtë vendim, një njoftim të posaçëm prej organizatorëve morën Hasan Prishtina, Aqif Pashë Elbasani dhe Ahmet Zogu, të cilit organizatorët i kërkuan të vinte më herët në Tiranë.

Në një kopje të thirrjes që iu drejtua popullit, nënshkruar prej Rauf Ficos, dhe që ndodhet në arkivin familjar të familjes së tij, thuhet:

*“Të ndershme Katundarisë së;...*

*Për me sigurue bashkimin e njesin e Kombit dhe me pre propagandat e huaja, u pa mirë me ba një mbledhje në Tiranë.*

*Në këtë mbledhje u mendua që nga çdo qark të vinë dy përfaqësues. Këta zotrinjë duhet të kenë dhe një letër-vërtetim prej katundarisë së qarkut të tyne.*

*Mbledhja do të bëhet në 19 dhjetor 1918 allafrënga.*

*Përfaqësuesit duhen më 18.12.918 të mërkurën në Tiranë që të mund të nesërmen me fillue nga bisedimi.*

*Tiranë 7. shindre 918. Firma Rauf Fico”<sup>9</sup>.*

Në dokumentin dhe ftesën për pjesëmarrjen në këtë kongres, grupi organizator theksonte: *“Çështjet që do të diskutohen, bëhen për të siguruar bashkimin e njehsimin e kombit dhe me pre propagandën e huaj, mbledhja do të bëhet më 19 dhjetor 1918 në Tiranë.”<sup>10</sup>* Ky kongres u mbledh në kohën kur u thirrën në Romë Turhan Pasha dhe Myfid Libohova, sikurse dihet, për formimin e një qeverie proitaliane. Kjo mbledhje, që u konsiderua një kongres për çështje kombëtare, diskutoi këto çështje themelore:

1. Sigurimi i paqes dhe i qetësisë në çdo qark. Mbajtja prej popullit e qeverive ekzistuese derisa të formohet një qeveri e përkohshme.

2. Lidhja e besës për gjaqet dhe armiqësitë.

3. Mbajtja e një mbledhjeje të dytë në një vend që do të pranohej nga pjesëmarrësit. Në këtë mbledhje (19.XII.1918), do të merrnin pjesë nga dy përfaqësues për çdo qark (kaza). Kështu, do të përfaqësohej gjithë populli shqiptar e do të merreshin masat e duhura.

4. Masat që duheshin marrë për të siguruar nga ana e fuqive italiane, franceze dhe serbe zgjedhjen dhe kalimin e delegatëve në qarqet që gjendeshin nën pushtimin e ushtrive të tyre.

5. Çuarja e një telegrami falënderimi dhe mirënjohjeje Qeverisë Italiane për lejen dhe ndihmën për këtë mbledhje<sup>11</sup>.

6. Në këtë mbledhje u diskutua:

a) formimi i një kabineti të ri, i cili do përfaqësonte gjithë Shqipërinë e do të mbronte të drejtat dhe interesat kombëtare

përpara qeverive të huaja dhe Kongresit të Paqes. (Konferencës së Paqes 1919–Sh.H.).

b) zgjedhja e delegatëve që do të përfaqësonin Shqipërinë në Konferencën e Paqes në janar 1919.

c) bërja e një apeli Fuqive të Mëdha, sidomos vendeve të Antantës, për mbrojtjen dhe marrjen nën kujdes të të drejtave kombëtare shqiptare<sup>12</sup>.

Hasan Prishtina, pasi lexoi projektprogramin e këtij Kongresi, i shkruan Raufit një letër, në të cilën theksonte:<sup>13</sup>

*“Rauf Bej Efendiut:*

*Zotni!*

*Nuk asht e mundun që të caktojmë qysh tani, natyrisht se si e do interesa e Atdheut. Mundet që ajo interes nevojitet rrënimin e qeverisë së soçme, ose dhe forcimin e saj. Pra pika që do të përdoret për qeverinë do të jetë tepër elastike, bile në ashtë e mundur do që ma mirë të mos përdorej një e tillë pikë (artikull). Pse nevoja e një aso pike në program, nuk e ekskludon propabilitetin që ata që do të vijjnë (në kongres–Sh.H.) të thonë se na jemi zgjedh në bazë të programit që na keni çue, jashtë këtij s’mund të veprojmë dhe s’mund të japim vendim tue mos pas kompetencë. Mbas mendimit tim, programi të hartohet tue pas parasysht këto pika.”<sup>14</sup>*

Mbi zarf, Hasan Prishtina kishte shkruar: *“I adresohet, të ndertit Rauf Bej efendiut: Nënëshkruhet përforcimi i delegacionit në program, pa tjetër, shpresoj të sjell një përfundim të mirë”<sup>15</sup>.*

Situatën në qarqet e thirrura për këtë mbledhje e bën të qartë Haki Stërmilli në një letër që i dërgon Rauf Ficos nga nënprefektura e Matit me nr. 20, datë 14 dhjetor 1918. Ai shkruan: *“Si kundër jam lut me raportin e parë nr. 19, për me çue një fuqi, e me sot prap po i përsërisim lutjet tue bam fjali si vijon posht.*

Parësia e Matit sot asht e ndame në dy parti e njana nga këto ashtë e qeverisë shqiptare e tjetra e Esatit... i cili ka marë mjaft të holla nga Serbia.

Letrat e ardhuna nga Tirana, në vend që ta mbledhin, e kanë shkatërru fare, ka një përshifje të lig për shkak të letrave të tjera që kanë ardh nga Tirana me nënëshkrimin e Shefik Kondit e të një tjetri të cilët porosisin për me mos marr pjesë në këtë mbledhje se qenka rol i një tosku për me i poshtëruë gegët!...

Veç kësaj mbledhje që bëhet atje, nëpërmjet Serbisë po bëhet një tjetër në Dibër, ku ka ardhur sekretari i Esat Pashës, Ymer Efendi

Tirana dhe i quajtura Kurt Aga prej Lisi bashk me shokët e tij... Këto veprime u ban për 24 orë këtu dhe në Dibër, ku po derdhen napolonat me grushta..."<sup>16</sup>

Në Kongresin e Tiranës morën pjesë si përfaqësues të Tiranës Abdi Toptani dhe Ismail Ndroqi, ndërsa Rauf Ficoja si përfaqësues i pushtetit vendor. Gjithashtu, morën pjesë Sotir Peci, Myslim Beshiri, Mytesim Këllici, Sinan Hoxha etj.

Kryetar i Kongresit ishte Abdi Toptani. Në Kongres iu bë një ftesë personale Ahmet Zogut. Më vonë u njoftua edhe Aqif Pashë Elbasani, Hasan Prishtina dhe Sulejman Delvina. Ky kongres i parapriu atij të Lushnjës<sup>17</sup>.

Kongresi mori disa vendime:

1. *Qeveria vendore të vazhdojë punën nën mbrojtjen e popullit deri në formimin e një kabineti.*

2. *U lidh besa për pajtimin e gjatëve dhe armiqësive për një vit.*

3. *Çdo kaza të formonte një komision prej 5 vetash, nën urdhrat e titullarit të pushtetit vendor, i cili do të vepronte për rregullimin e problemeve të pushtetit vendor.*

4. *Në 11 janar 1919 të mbahej në Krujë një mbledhje kombëtare ku të merrnin pjesë nga dy përfaqësues për çdo kaza.*

5. *U hartua një kërkesë për komandën italiane në Tiranë dhe atë franceze në Shkodër për të lejuar ardhjen e delegatëve në Kongresin e Krujës.*

6. *Të formohej një komision veprues për mbledhjen e Krujës, në përbërje të të cilit ishin Abdi Bej Toptani, Xhemal Belegu dhe Muharrem Pengjili<sup>18</sup>.*

Kongresi i Tiranës (19 dhjetor 1918) ishte në vazhdën e përpjekjeve të atdhetarëve shqiptarë për të organizuar pushtetin administrativ të vendit dhe mbrojtjen e çështjes kombëtare shqiptare me një zë përballë intrigave të kohës.

Në Tiranë vepronin disa patriotë, si: Rustem Petrela, Abdyl Ypi, Abdi Toptani, Hoxhë Kadriu, Abdullah Haxhi Mehmeti, Hasan Prishtina, Osman Myderrizi, Sotir Peci, Rauf Ficoja, Sami Vrioni, Ismail Ndroqi, Xhemal Belegu, Muharrem Pengjili, Sali Hoxha, Selim Shpuza etj., të cilët bënë përpjekje për thirrjen e një kongresi tjetër në Tiranë në maj të vitit 1919.

Njoftimin e parë për kongresin e majit 1919 në Tiranë e jep prefekti i Durrësit Abdyl Ypi (nga i cili varej Tirana), më 16 dhe

30 prill 1919<sup>19</sup>. Komisioni organizator përbëhej prej elementëve feudalë, të borgjezisë qytetare dhe intelektualëve të Tiranës. Ky kongres kishte për synim të rikthente në krye të Shqipërisë Esat Pashën. Sipas Hoxhë Kadriut, "... Abdy Ypi,... Rauf Fico, Hamit Bej Toptani dhe Omer Bej Shjaku, pasi u morën vesh mes vedi, morën iniciativën me mbledh një kongres për me sjell në Shqipëri Esat Pashën"<sup>20</sup>. Organizatorët caktuan si datë për zhvillimin e kongresit 5 majin dhe, për të marrë pjesë në këtë kongres, ishin ftuar vetëm trevat e Shqipërisë së Mesme. Ftesa theksonte se në kongres do të diskutoheshin:

- bashkëpunimi me qeverinë e Durrësit;
- marrja në analizë e veprimtarisë së saj dhe
- çështjet e politikës së jashtme të Shqipërisë.

Në ftesën e pjesëmarrjes në këtë kongres thuhej: "... tue iu paraqit mendimin për një mbledhje që do të shqyrtoj punët qi do të bahen përjashta dhe përbrenda Shqypënisë"<sup>21</sup>.

Kësaj iniciative iu kundërvunë si Qeveria e Durrësit, ashtu edhe italianët, që kontrollonin vendin në atë periudhë, ndaj ky kongres dështoi<sup>22</sup>. Në ditarin e tij, Rauf Ficoja shkruan: "Po rezervoov telegramin e Myfid beut. Është kopja e Telegramit që Myfid Beu na ban nga Durrësi më 1918 për të bërë Kongresin e Durrësit e për të ndalur kongresin e Tiranës."<sup>23</sup> Në telegram, Myfid Libohova shkruante: "Delegatët e Shqipërisë së Poshtëme janë mbledhur këtu në Durrës ku po priten edhe delegatët e Shqipërisë së Sipërme me të Mesme për të bërë një mbledhje kombëtare të përgjithshme e cila do të ketë për qëllim zgjedhjen e një dërgate në Europë e cila t'i dal zot të drejtave t'ona edhe për të formuar një organizëm për administratën e brendshme të Shqipërisë. Ca nga delegatët e Shqipërisë së sipërme e të Mesme gjenden në udhë e nesër arrijnë këtu. Pra na të nënëshkruarit u lutemi edhe atyre zotrinjëve që gjenden aty të mbledhun në Tiranë, gjerë nesër mbrama në qoftë se s'munden më shpejtë, të arrijnë ndër nesh këtu se puna nuk pret e interesat gjallnore të atdheut, kërkojnë shpejtim e këmbim të mendimesh të atdhetarëve të vërtetë.

*Për delegatët e mbledhur në Durrës "*.<sup>24</sup>.

Myfid Libohova, Mehmet Konica, Luigj Gurakuqi, Fejzi Alizoti dhe Mustafa Kruja<sup>25</sup>.

Atdhetarët e Tiranës, duke ndjekur me vëmendje gjendjen, nuk hoqën dorë nga thirrja e kongresit të Tiranës. Momenti

historik kërkonte një qeveri të tillë që të luftonte kundër synimeve aneksioniste të fqinjëve, në radhë të parë kundër Italisë, e cila punonte për të vënë në jetë Traktatin e Fshehtë të Londrës<sup>26</sup>. Për këtë qëllim, ajo ngriti edhe të ashtuquajturat komitete të shpëtimit në zonën Vlorë–Durrës, detyra e të cilave ishte t’i dorëzonin Italisë trojet shqiptare.

Në këto rrethana tepër delikate, me sa duket edhe me këshillën dashamirëse të anglezit Eden, funksionar i MPJ angleze dhe mik i Edit Durhamit, atdhetarët e Tiranës ndërmorën nismën për thirrjen e Kongresit të Lushnjës. Lidhur me këtë, Xhemal Kusi në kujtimet e tij shkruan: *“Tamam në këtë kohë kritike, por të volitshme, një anglez i quajtur “Eden”, funksionar i MPJ angleze, mik i Shqipërisë dhe i zonjës shqiptarofile, Edith Durham, vjen këtu në Shqipëri si i pa njohur, jo nga Italia, por nga kufiri grek ose jugosllav dhe i shoqërum prej dragomanit Gjakovas, Andre Krasniqit, ish-oficer anglez në lirim. Dhe shkon e takohet me Abdi Bej Toptanin, fill e në çiflikun e tij, ku ai banonte atëkohë dhe i kishte thënë se “Tue qënë se qeveria shqiptare ka kërkue në Konferencën e Paqes mandatin e Italisë, për këtë shkak, Shqipëria asht në rrezik që të coptohet... Sado që qeveria Imperjale Angleze, për këtë rast nuk ishte më e dëshirue të vuemun në zbatim të traktatit 1915 të Londrës, me megjithëkëtë nuk mund të dali sheshit kondra Italisë, për arsye se ajo në këtë luftë ka qënë aleate me Anglinë dhe premtimit që i bahesh asaj tue ia dhanë Vlonën me gjithë rrethet, u detyrue të lidh aleancë, tue u shkëputun kështu nga aleanca që kishte pat traktat me Gjermaninë dhe Austro-Hungarinë përpara. Prandaj tue u gjetur tashti përpara këtyre kushteve të cilat nuk e lejojnë qeverinë angleze dhe atë franceze që të mbrojnë tashti çështjen e Shqipërisë tue vunë për mbështetje paktin e 1913-ës e vetmja rrug e shpëtimit të saj nga ky coptim, ka me qënë që ju populli shqiptar të ngeheni e të rrëzoni këtë qeverinë e sotshme dhe tue deklarue mospranimin kurrsesi të mandatit italian, të kërkoni respektimin e kufijve të 1913-së të Konferencës së Londrës dhe se përndryshe “ju preu e zeza”.*<sup>27</sup>

“Kështu i foli anglezi, miku z. Eden, patriotit shqiptar, z. Abdi Bej Toptanit, dhe, mbas këtyre fjalëve, kishte kërkue leje të ikte, por siç e rrëfente Abdi Beu, nuk e kishte lën me ik, tue i sigurue atë se nuk kishte mundësi rreziku dedektivash në atë trevë.

Të nesërmen në të agueme, mbasi miku anglez ishte tue u largue, Abdi Beu, ju kishte falenderue dhe një herë për sugjerimet

e këshillat e tij të vlefshme që i dha përsa i përkiste shpëtimit të atdheut dhe e kishte sigurue se qysh tashti ai do të fillonte së vepruari me çdo kusht për të marrë iniciativën mbi mbledhjen e një kongresi, për rrëzimin sa më shpejt të qeverisë së Durrësit.

Atë ditë Abdi Beu me anë të një shërbëtori të tij, i kishte dërguar një letër, dhëndrit të vet, Abdyl Bej Ypit, që ishte prefekt i Durrësit, që të nesërmen të ndodhesh medoemos në Tiranë dhe pastaj vetë kishte zbritur në konakun në qytet, ku menjëherë kishte thirrur gjirokastriten, z. Rauf Ficon, të cilin populli i Tiranës me gjithë rrethe e simpatizojshin fortë nga shkakut se ky gjatë sundimit të Austro-Hungarisë si nënëprefekt që qe, ishte sjellun shumë mirë ndaj tij dhe, mbasi ja numëroi këtij të gjitha mbi sa e kishte këshillue ai anglezi për rrëzimin e qeverisë së Durrësit, Rauf Fico ishte treguar i gatshëm për të bashkëpunuar për këtë qëllim, e ahëre Abdi beu i kishte dërgue letër Zogut në Mat, tue porositun që të vinte sa më shpejt në Tiranë...

Kur Ahmet Zogu u këthye nga Elbasani dhe njoftoi se Aqif Pashaj e priti me gëzim të madh këtë iniciativë patriotike, ahëre propozimi i Abdi Beut për nevojën e zgjerimit të grupit iniciator, mbasi u pëlqye edhe prej shokëve, Abdyl Bej Ypi, Rauf Fico dhe Ahmet Bej Zogut, si pjestarë në këtë grup, thërritën parësinë nacionaliste të Tiranës, kryetrarin e Bashkisë Ismail Ndroqin, Myftiun Myteselim Këllëçin, Fuat Bej Toptanin, Refik Bej Toptanin, Sheh Ahmet Pazarin, Hafiz Dalliun e Myslim Beshirin."<sup>28</sup>

Kongresi i Tiranës (dhjetor 1918) dhe puna e atdhetarëve tiranas, midis të cilëve dhe ajo e Rauf Ficos, ndikuan në përgatitjen e terrenit për zhvillimin e Kongresit të Lushnjës.

Gjatë kësaj periudhe Rauf Fico kreu edhe disa veprime të tjera atdhetare, si: hapja e strehës vafnore të Tiranës, sistemimi i gjimnazit të Tiranës, futja e gjuhës shqipe në administratën shtetërore, marrja e disa masave për Kongresin e Lushnjës etj.<sup>29</sup>

## Shënime:

<sup>1</sup> AMPJ, Viti 1939, dos. 115, fl. 96. Abdurrahman Rauf Ficoja lindi në Sanë të Jemenit nga prindër shqiptarë me origjinë nga Gjirokastra, më 13 mars të vitit 1881 dhe vdiq në Tiranë, më 23 janar të vitit 1944, në moshën 63-vjeçare. Pasi kreu Shkollën e Lartë të Mylqijes në Stamboll, u emërua sekretar i valiut të Janinës, në vitin 1903. Raufi kreu disa detyra administrative si nënprefekt e prefekt në Konicë, Margëlliç, Himarë, Kërçovë, Anadoll, Berat, Vlorë, Tiranë dhe Shkodër. Ai punoi në administratën e Qeverisë së Vlorës, Vidit, Turhan Pashës, Sulejman Delvinës, Idhomeno Kosturit, Pandeli Evangjelit, Koço Kotes, Mehdi Frashërit etj. Postet më të larta ishin ato të zv/Ministrit të PB, të Ministrit të PB dhe të Ministrit të PJ. Rauf Fico ishte një diplomat i Klasit të Parë. Kariera diplomatike fillon në vitin 1926 si Ministër fuqiplotë në Angora dhe vazhdon me, po këtë detyrë, në Beograd, Sofje, Athinë, Berlin. Gjatë jetës së tij ai pati kontakte me disa personalitete të kohës, ku spikasin takimet me Hitlerin, Musolinin, Geringun, Qemal Atatürkun, mbretërit Jorgo dhe Boris, Venizellosin, Solën etj.

<sup>2</sup> *Kongresi i Lushnjës dhe Lufta e Vlorës*, Tiranë, 1974. f. 29.

<sup>3</sup> AQSH, F. Arkivi vetjak i Lumo Skëndos (Mithat Frashërit), dok. 203.403 dhe 203, 404.

<sup>4</sup> N. Nishku, "Akte të çmueshme për kombin", Gazeta "Tirana", nr. 489, f. 4.

\* Rauf Fico në atë periudhë ishte nënprefekt i Tiranës.

<sup>5</sup> AF, viti 1918, dos. 2. f. 46. Vendim i takimit në Paris në zyrën e Rauf Ficos, 7 dhjetor allafrenga 1918.

<sup>6</sup> Sh. Hysi, Rauf Fico, diplomat dhe shtetar i shquar, Mësonjtorja, Tiranë, 2007, f. 45-56.

<sup>7</sup> K. Frashëri, *Historia e Tiranës, vep. e cit.*, f. 403.

<sup>8</sup> AF, viti 1918, dos. 4. f. 44/c. Thirrje drejtuar katundarisë së Tiranës. 7 dhjetor 1918.

<sup>9</sup> Po aty, f. 4.

<sup>10</sup> AF, viti 1918, dos. 4, f. 46/1.

<sup>11</sup> Rauf Fico, *besniku i vetësundimit tonë*, Gazeta "Atdheu", 15 janar 1994, nr. 21, f. 4.

<sup>12</sup> AQSH, F. 441, pa vit, dos. 3, f. 11.

<sup>13</sup> AQSH, F. 687, pa vit, dos. 3, f. 11.

<sup>14</sup> Po aty, f. 10.

<sup>15</sup> AF, viti 1918, dos. 4. f. 65/c. Haki Stërmilli. Letër nga Nënprefektura e Matit, më 14 -XII-18.

<sup>16</sup> Po aty, f. 4.

<sup>17</sup> L. Nosi, *Dokumenta për t'i shërbyer historisë tonë kombëtare*, Elbasan, mars 1924, nr. 1, f. 24.

<sup>18</sup> AQSH, F. DPB, viti 1919-1920, dos. 21, f. 2.

<sup>19</sup> AQSH, F. 422, pa vit, dos. 17, f. 120: *Kujtime e shënime prej Hoxha Kadriut*.

<sup>20</sup> Revista "Zani i Naltë", maj 1937, f. 350-351.

<sup>21</sup> M. Çami, K. Nushi, *Orvatjet e Qeverisë së Durrësit dhe të pushtuesve italianë për ndalimin e Kongresit të Lushnjës dhe dështimi i tyre*, në "Kongresi i Lushnjës dhe Lufta e Vlorës", Tiranë, 1974, f. 19- 54.